



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 101, datë 29.02.2024

PËR

DEKLARIMIN E PËRFUNDUAR, PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3 e 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, në përfundim,

VENDOSI:

I. Të deklarojë të përfunduar, pa një vendim përfundimtar, shqyrtimin e kërkesave të Gjykatës Administrative të Apelit, për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, si më poshtë:

1. Kërkesës nr. 16 prot., datë 12.01.2023, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditës {...}, e paditur: {...} me objekt: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”, çështje kjo e veçuar sipas vendimit nr.01.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Kërkesës nr. 555 prot., datë 09.11.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditëse {...}, palë të paditur {...}, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë me objekt: “Shfuqizimin e urdhrit nr. 661, datë 13.12.2018, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin...”,

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR